



Ndihma për Afganistanin, konsolidimi i Europës, zgjerimi i partneriteteve, përballimi i sfidave të reja

Takimi i Bukureshtit, që u zhvillua prej 2 deri më 4 prill 2008, ishte më i madhi i NATO-s i mbajtur ndonjëherë. Mbi 60 shtete morën pjesë në të, si dhe përfaqësues të lartë nga shumë institucione të tjera kryesore, përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të KB-së dhe Presidentin e Komisionit të BE-së. Në takim u theksua vendosmëria e Aleancës për të punuar ngushtësisht me bashkësinë ndërkombëtare për përballimin e sfidave të sigurisë të shekullit 21, si dhe ndihmesa e pashembullt e saj për forcimin e sigurisë dhe të stabilitetit në një mjedis strategjik të shpejtndryshueshëm.

Në Bukuresht, udhëheqësit e NATO-s nënvizuan angazhimin afatgjatë të Aleancës në Afganistan dhe rëndësinë e të punuarit nga afër me të gjitha shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin përparimin atje. Duke ripohuar politikën e dymë të hapura të NATO-s dhe zotimin e saj për forcimin e sigurisë dhe të stabilitetit në Europë, ata ftuan Shqipërinë dhe Kroacinë për të filluar bisedimet e pranimit për anëtarësim dhe u pajtuan në idenë se Ukraina dhe Gjeorgjia do të bëhen një ditë anëtarë të NATO-s. Udhëheqësit e Aleancës theksuan gjithashtu zotimin e NATO-s ndaj misionit të saj KFOR në Kosovë dhe misionit stërvitor në Irak, si dhe gatishmërinë e Aleancës për të vijuar mbështetjen e Bashkimit Afrikan në Sudan dhe në Somali. Ata i dhanë një shtysë të mëtejshme përpjekjeve të pareshtura për transformimin e Aleancës, që t'i përgjigjet kërkesave operative dhe kërcënimeve të reja ndaj sigurisë, përfshirë nxjerrjen e një deklarate të përbashkët mbi mbrojtjen kundërraketë. Ata gjithashtu patën një diskutim të frytshëm me Presidentin e Rusisë për mënyrën si mund të punojnë së bashku Aleanca dhe Rusia për përballimin e sfidave të sigurisë.



Ndihma për Afganistanin

Në Bukuresht, udhëheqësit e Aleancës theksuan se siguria euro-atlantike dhe në shkallë të gjerë ndërkombëtare është e lidhur ngushtë me të ardhmen e Afganistanit si një shtet demokratik, paqësor, respektues i të drejtave të njeriut dhe i sigurt prej kërcënimit nga terrorizmi. Për atë arsye, Forca Ndihmëse e Sigurisë Ndërkombëtare (FNSN) nën mandatin e KB-së mbetet përparësia kryesore e NATO-s. U vu në dukje se ishte vërejtur një përparim i ndjeshëm që kurse NATO mori përgjegjësinë e komandimit të misionit të FNSN-së në gusht 2003, por se mbeteshin ende sfida për qeverinë afgane, NATO-n dhe pjesën tjetër të bashkësisë ndërkombëtare.

Aleanca ka mbështetur prej kohësh një “qëndrim gjithëpërfshirës” ndaj Afganistanit dhe sfidave të tjera të sigurisë që përafrojnë përpjekjet civile dhe ushtarake. Në Bukuresht u vu në veprim ky “qëndrim gjithëpërfshirës”. Në një mbledhje të mbajtur enkas për Afganistanin, bashkë me aleatët morën pjesë edhe vendet partnere në FNSN, Presidenti Afgan, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së, Presidenti i Komisionit të BE-së, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Drejtori Administrativ i Bankës Botërore dhe Zëvendësministri i Jashtëm i Japonisë. Mbledhja shënoi fillimin e një faze të re në angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare, ku një përpjekje ushtarake mbizotëruese për ruajtjen e sigurisë dhe të stabilitetit po zhvendoset drejt një kahje me një theks më të fuqishëm ndaj përpjekjeve për rindërtim nën drejtimin e civilëve dhe ndaj pronësisë afgane.

Vendet ndihmëdhënëse me trupa të FNSN-së miratuan një vizion strategjik për Afganistanin, i cili udhëhiqet nga katër parime kryesore:

- një angazhim të qëndrueshëm dhe të përbashkët afatgjatë;
- mbështetje për forcimin e udhëheqjes afgane dhe të përgjegjshmërisë;
- një qëndrim gjithëpërmblëdhës nga bashkësia ndërkombëtare për të përafuar përpjekjet civile dhe ushtarake;
- zgjerim të bashkëpunimit dhe angazhimit me fqinjët e Afganistanit, veçanërisht me Pakistanin.

Për më tepër, vendet ndihmëdhënëse të FNSN-së miratuan edhe një plan strategjik politiko-ushtarak gjithëpërfshirës për Afganistanin, i cili përcakton piketa të qarta dhe realiste për të mundur një përpjekje më të përqendruar dhe për të vlerësuar përparimin paanësisht. Plani gjithashtu realizon udhëheqjen për mënyrën si të ndërveprohet më me frytshmëri me qeverinë afgane dhe organizatat e tjera ndërkombëtare. Së fundi, një numër vendesh aleate dhe partnere kumtuan gjithashtu zotimet e tyre për dërgimin e forcave të reja në FNSN dhe forma të tjera të mbështetjes.



Konsolidimi i Europës

Takimi i Bukureshtit nënvizoi angazhimin e fuqishëm e të vijueshëm të NATO-s për të ndihmuar në krijimin e një Europe të pacenuar, të lirë dhe në paqe. Shqipëria dhe Kroacia u ftuan të fillonin bisedimet për hyrje në NATO. Qëllimi është që të nënshkruhen Protokollet e Hyrjes deri nga fundi i korrikut 2008 dhe të përfundojë procesi i ratifikimit pa vonesë. Në takim u ripohua se dera e NATO-s mbetet e hapur për demokracitë e tjera europiane që do të ishin të gatshme dhe të afta për të marrë përsipër përgjegjësitë e anëtarësisë.

Ashtu si Shqipëria dhe Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë* ka qenë pjesëmarrëse prej disa vitesh në Planin e Veprimit për Anëtarësim (PVA) në NATO për t'u përgatitur për një anëtarësim të mundshëm. Udhëheqësit e vendeve aleate ranë në ujdi që vendi do të ftohej për të hyrë në NATO menjëherë sapo negociatat në vazhdim e sipër lidhur me emrin e saj do të çonin në një zgjidhje të pranueshme të ndërsjellë.

Gjeorgjia dhe Ukraina kanë qenë të përfshira në Dialogët Intensivë me NATO-n lidhur me aspiratat e tyre për anëtarësim dhe reformat përkatëse. Udhëheqësit e vendeve aleate u pajtuan në idenë se të dy vendet do të bëhen anëtarë të NATO-s dhe se Aleanca do të angazhohet fuqimisht me të dyja vendet për të trajtuar çështjet e mbetura pezull në lidhje me aplikimet e tyre për t'u përfshirë në procesin e PVA-së. Në dhjetor 2008, ministrat e jashtëm të NATO-s do të bëjnë një vlerësim të parë të përparimit të shënuar nga secili prej të dy vendeve.

Po ashtu, në përgjigje të aspiratave euro-atlantike dhe përpjekjeve reformuese të Bosnjes e Hercegovinës dhe të Malit të Zi, këto dy vende u ftuan të fillonin një Dialog Intensiv, pa u kushtëzuar me ndonjë vendim të mundshëm të Aleancës. Aleatët ripërsëritën gjithashtu gatishmërinë e tyre për të thelluar bashkëpunimin me Serbinë, veçanërisht nëpërmjet zhvillimit të një Plani Individual të Veprimit të Partneritetit dhe për të shqyrtuar një Dialog Intensiv në vijim të një kërkesë nga Serbia.

Udhëheqësit e Aleancës ripohuan angazhimin e tyre ndaj stabilitetit në të gjithë Ballkanin dhe përsëritën se Forca e fuqishme e Kosovës (KFOR) e drejtuar nga NATO, e cila u përqendrua fillimisht në qershor 1999, do të mbetet në Kosovë mbi bazën e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-së. NATO dhe KFOR-i do të vijojnë të punojnë me autoritetet dhe me Kombet e Bashkuara, me Bashkimin Europian dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë për të mbështetur zhvillimin e një Kosove të qëndrueshme, demokratike, shumetnike dhe paqësore.

** Turqia e njeh Republikën e Maqedonisë me emrin e vet kushtetues.*



Zgjerimi i partneriteteve

Partnerët e NATO-s janë me rëndësi vendimtare për mënyrën si vepron Aleanca në kohën e sotme. Marrëveshjet e partneritetit të Aleancës përfshijnë Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA); marrëdhëniet e veçanta me Rusinë dhe Ukrainën; Dialogun Mesdhetar me shtatë vende në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme; Nismën e Bashkëpunimit të Stambollit me shtatë vende të rajonit të Gjirit dhe marrëdhëniet dypalëshe të një niveli më të ulët zyrtar me vende partnere përreth rruzullit tokësor. Në Bukuresht, aleatët vunë në dukje interesin e tyre të vijueshëm për përfshirjen e partnerëve në misione dhe operacione, si dhe për përshtatjen e dialogut e të bashkëpunimit në pajtim me interesat dhe shqetësimet e tyre të veçanta.

Në një drekë pune jozyrtare, kryetarët e shteteve dhe të qeverive të KPEA-së mirëpritën vendimin e Maltës për t'u rikthyer në Partneritetin për Paqe (PpP) dhe për t'u përfshirë në KPEA-në. (Malta u fut në programin e PpP-së në prill 1995 por e pezulloi pjesëmarrjen e saj në tetor 1996).

Në një mbledhje të Komisionit NATO-Ukrainë (KNR), Presidenti i Ukrainës falënderoi aleatët për “sinjalin e qartë” që dhanë për të ardhmen e marrëdhënieve të Ukrainës me NATO-n nëpërmjet kumtimit se vendi do të bëhet anëtar i NATO-s. Udhëheqësit e vendeve aleate përshëndetën përparimin e Ukrainës në reformën në sektorët e mbrojtjes e të sigurisë dhe lëvduan ndihmesën e saj të rëndësishme në misionet dhe operacionet e drejtuara nga NATO.

Udhëheqësit e vendeve aleate u takuan me Presidentin e Rusisë në mbledhjen e parë në nivel takimi të Këshillit NATO-Rusi (KNR) qysh prej themelimit të saj në maj 2002. Udhëheqësit e KNR-së ishin të një mendimi për rëndësinë strategjike të partneritetit NATO-Rusi dhe për vlerat e KNR-së si një forum për dialog politik të hapur, përfshirë çështje ku aleatët dhe Rusia mund të kenë mospërputhje. Para mbledhjes së KNR-së, NATO dhe Rusia nënshkruan një marrëveshje për lehtësimin e kalimit të përkohshëm me rrugë tokësore nëpër territorin e Rusisë të pajisjeve jo ushtarake të paracaktuara për FNSN-në.

Aleatët bënë thirrje për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet NATO-s dhe Kombeve të Bashkuara në ruajtjen e paqes e të sigurisë dhe nënvizuan vlerën e një bashkërendimi të frytshëm e të dobishëm ndërmjet dy organizatave. Ata theksuan gjithashtu vendosmërinë e tyre për të përsosur partneritetin strategjik NATO-BE, i cili mbulon një gamë të gjerë çështjesh me interes të përbashkët dhe që është i një rëndësie gjithnjë e më të madhe në Afganistan dhe në Kosovë. Udhëheqësit e vendeve aleate ripërsëritën se “një BE më e fuqishme do të ndihmojë më shumë për sigurinë tonë të përbashkët”.



Përballimi i sfidave të reja

Në Bukuresht, udhëheqësit e vendeve aleate theksuan nevojën e ruajtjes së aftësisë së NATO-s për t'iu përgjigjur angazhimeve operative e për të kryer të gjitha llojet e misionëve dhe i dhanë një shtysë dhe drejtim të mëtejshëm transformimit në vijim të forcave dhe aftësive mbrojtëse të Aleancës. Ata nënvizuan gjithashtu nevojën për përshtatjen e strukturave dhe të proceseve në Shtabin e NATO-s dhe ngarkuan Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s që, për këtë qëllim, të hartonte në kohë propozimet për Takimin më 2009.

Në Takimin e Bukureshtit ekzistoi një konsensus i gjerë në atë se, përveç përmbushjes së kërkesave të sotme, veçanërisht në lidhje me misionet dhe operacionet e NATO-s, Aleanca duhet të përgatitet edhe për sfidat e reja jo tradicionale, të tilla si përhapja e armëve të dëmtimit në masë, mbrojtja nga sulmet me mjete kompjuterike ose ndërprerja e furnizimit me energji.

Udhëheqësit e vendeve aleate ranë në marrëveshje se vendosja e planëzuar e pajisjeve amerikane të mbrojtjes kundërraketë me bazë në Europë do të ndihmojë në mbrojtjen e shumë aleatëve dhe u pajtuan në idenë se këto kapacitete do të jenë pjesë përbërëse e çdo arkitekture të ardhshme të një mbrojtjeje të gjerë kundërraketë të NATO-s. Mundësitë përzgjedhëse të arkitekturës së një mbrojtjeje të përgjithshme kundërraketë, për zgjerimin e mbulimit të territorit të të gjithë aleatëve që nuk mbulohet nga sistemi amerikan, do të shqyrtohen në Takimin tjetër

të NATO-s më 2009. Duke nxitur Rusinë për të përfituar nga propozimet amerikane për bashkëpunim mbi mbrojtjen kundërraketë, ata theksuan gatishmërinë e tyre për të zbuluar mundësinë për lidhjen në një kohë të përshtatshme të sistemeve të mbrojtjes kundërraketë të SHB-së, NATO-s dhe Rusisë.

Aleatët mbështetën një vijë veprimi për mbrojtjen kompjuterike, duke nënvizuar nevojën që NATO dhe shtetet të mbrojnë sistemet bazë të informacionit; të shkëmbejnë praktikatat më të mira; të sigurojnë aftësinë për të ndihmuar vendet aleate, sipas kërkesave të paraqitura, për t'iu kundërvënë sulmeve me mjete kompjuterike. Ata janë në pritje të ecurisë së zhvillimit të kapaciteteve të mbrojtjes kompjuterike dhe të forcimit të lidhjeve ndërmjet NATO-s dhe autoriteteve kombëtare në këtë fushë.

Udhëheqësit e vendeve aleate shqyrtuan gjithashtu një raport mbi rolin e NATO-s në sigurimin e energjisë, i cili përcakton parimet udhëheqëse dhe përvijon rrugëzgjdhjet e rekomandimet për veprimtaritë e mëtejshme, veçanërisht në pesë fusha kryesore, ku NATO mund të sigurojë vlera të dobishme: grumbullimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe i të dhënave të zbulimit; parashikimi i stabilitetit; rritja e nivelit të bashkëpunimit ndërkombëtar e rajonal; mbështetja për administrimin e pasojave dhe mbështetja për mbrojtjen e infrastrukturës së rëndësishme të veçantë. Përparimi do të shqyrtohet në Takimin e vitit 2009.



Udhëheqësit e vendeve aleate vendosën të takohen përsëri vitin e ardhshëm në Strasburg, Francë dhe në Kehl, Gjermani, për të festuar 60-vjetorin e NATO-s. Takimi do të sigurojë mundësinë për të shqyrtuar transformimin e NATO-s dhe për të qartësuar e fuqizuar më tej vizionin e Aleancës për rolin e saj në përballimin e sfidave të shekullit 21. Ata arritën në marrëveshje që, në Takimin e vitit 2009, të përgatitet për miratim një Deklaratë për Sigurinë e Aleancës për të krijuar truallin e përshtatshëm për këtë detyrë të rëndësishme.



**NATO Public Diplomacy Division /
Division Diplomatie publique de l'OTAN
1110 Brussels / 1110 Bruxelles
Belgium / Belgique
natodoc@hq.nato.int
www.nato.int**